



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.101/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurit S.B. nga L. të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.93/2018 të dt.08.02.2018, për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 187 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me dt.21.02.2019, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Blerim Igrishta, të akuzuarit dhe të dëmtuarit, në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpall ndërsa me datën 28.02.2019 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

S.B., nga i ati K. dhe e ëma F., i lindur me dt. ... në fshatin M. K.-L.1 me vendbanim në L.2, me nr. personal ... shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Më datë 31.12.2017, rrethë orës 11:42, në rrugën e “I.O.”, në L., me dashje ka përdorur forcën ndaj pratnerit familjar, bashkëshortes së tij, tani të dëmtuares F.B., ashtu që e dëmtuara pasi del të hedh mbeturinat e takon kunatin e saj me vajzen e tij ... vjeçare, i cili i kërkon të shkoj me të te argjendari për t’ia shpuar veshët vajzës së tij dhe posa e dëmtuara kthehet para ndërtesës i del i pandehuri S.B. i cili ishte nën ndikimin e alkoolit dhe fillon ta fyej me fjalë fyese, e kap dhe e tërheq për flokësh, si dhe e godet me grushte nëpër pjesp të ndryshme të trupit,-

-me këtë ka kryer veprën penale Sulm nga neni 187 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 7, 21, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 187 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe dispozitave të nenit 365 të KPPK- së të pandehurin e gjykon me,

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara, F.B. udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në procedurë kontestimore.

DETYROHET i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të procedurës shumë prej 20-€, në emër të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumë prej 20-€ si dhe shumë prej 30.-€, në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj, PP.II.nr.93/2018 të dt.08.02.2018, e ka akuzuar të pandehurinn S.B. nga fsh M., për shkak të veprës penale Sulm nga neni 187 par.3 me par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, ka mbetur në tërësi praanë aktit akuzues dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili është bërë konform dispozitave ligjore dhe se i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që ti ketë parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se është penduar për atë qka ka ndodhur dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen këtë nuk do ta përsëris duke shtuar se me tani të dëmtuaren-bashkëshorten jetojnë së bashku, kanë 3 fëmijë dhe që nga ajo kohë më nuk kanë pasur probleme.

E dëmtuara në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se me të pandehurin nuk ka pasur më probleme që nga koha kur ka ndodhur ky rast, jetojnë së bashku dhe nuk i bahskangjitet ndjekjes penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të të pandehurit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 73 të KPRK-se, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen e mëparshme të kryesit, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti është penduar për veprën penale, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla të ngjashme dhe do të jem ma i kujdesëshem, e veqanarisht pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ndersa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e pergjegjesisë penale, pra faktin se i pandehuri ka qenë ia aftë ti kuptojë sjelljet dhe veprimet e tij, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së, ndërsa vendimi për pagesën e shumës në Fondin e Viktimave u bazu në nenin 39 të Ligjit për Mbrojtjen e Viktimave.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.

P.nr.101/18 dt.21.02.2019

**Sekretarja juridike
Nexhmije Ahmeti**

**GJYQTARI
Avdirrahman Gashi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.